



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 3 DHE 4 PRILL 2021**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 03. I 04. APRILA 2021. GODINE**

**PRILL - APRIL
2021**

Rendi i ditës

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Izbor Predsednika Republike Kosovo.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Filip Kosnet,

Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë,

Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian, ambasadori Tomas Shuniug,

Ambasadorë të vendeve mike të akredituara në Prishtinë,

Të gjithë ju që jeni të pranishëm në këtë seancë, duke përfshirë edhe mediat e nderuara, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të grupit prej 41 deputetëve.

Më lejoni në fillim t'ju përkujtoj lidhur me rëndësinë e respektimit të masave për mbrojtje nga pandemia COVID-19, duke u bazuar në manualin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe rekomandimet e IKSHP-së, përgjatë seancës është i obliguar përdorimi i maskave nga secili. Në sallë i kemi të pranishëm, Administrata më thotë, 82 deputetë, kështu që konstatoj se kemi kuorum të mjaftueshëm që të procedojmë.

Pika e vetme e rendit të punës në këtë seancë është:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Ju njoftojmë se në mbështetje të nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për President të Republikës së Kosovës janë nominuar zyrtarisht dy kandidatë: zonja Vjosa Osmani-Sadriu dhe zoti Nasuf Bejta. Ftoj përfaqësuesit e propozuesve që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesin arsyetimin për kandidatët e nominuar për president. Së pari këtë e bën Mimoza Kusari-Lila për kandidaten, zonjën Vjosa Osmani-Sadriu.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar ambasadorë të vendeve mike të akredituara në Kosovë,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuara media,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot para jush të prezantoj biografinë e kandidates tonë, doktor Vjosa Osmani-Sadriu.

Doktor Vjosa Osmani-Sadriu lindi më 17 maj 1982 në Mitrovicë, Republika e Kosovës. Shkollimin fillor dhe të mesëm e ka të mbaruar në Mitrovicë. Ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Prishtinës, ndërsa studimet master dhe studimet e doktoratës i ka mbaruar në Universitetin e Pitsburgut në Pensilvani të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Është zgjedhur deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës në pesë mandate. Në zgjedhjet e fundit ishte kandidatë për presidente të Republikës së Kosovës.

Në mandatet e kaluara ka udhëhequr Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, Komisionin për Integritet Evropian dhe ka qenë nënkryetare e Komisionit për Reformë Kushtetuese. Më 3 shkurt 2020 Vjosa Osmani u zgjodh kryetarja e parë grua e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Më 5 nëntor 2020 Vjosa Osmani është bërë ushtruese detyre e Presidentit të Republikës së Kosovës, pozitë që e ka mbajtur deri më 22 mars 2021.

Gjatë viteve 2006-2010, Vjosa Osmani ka shërbyer si shefe e stafit të Presidentit të Kosovës dhe këshilltare e lartë për çështje ligjore dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Ajo ka përfaqësuar Presidentin në Komisionin për Hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ka qenë anëtare e ekipit përfaqësues të Republikës së Kosovës në rastin para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

Që nga viti 2006 ka ligjëruar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa si profesor vizitor ka ligjëruar edhe në Universitetin e Pitsburgut në SHBA. Për disa vjet ka ligjëruar edhe në RTI apo në Universitetin Amerikan në Kosovë, Kolegjin AAB- Riinvest, si dhe ka mbajtur ligjërata tematike në universitete të tjera në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga Universiteti i Pitsburgut është nderuar me çmimin “Chef International Award”, është anëtare e Bordit të Rrjetit Parlamentar të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe anëtare në Komisionin drejtues të deputetëve të rinj të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Flet gjuhën angleze, turke, serbo-kroate dhe komunikimin në spanjisht. Është e martuar me Prindon Sadriun, me të cilin kanë dy vajza binjake, Anda Elisa Sadriu dhe Dua Tiara Sadriu. Vjosa Osmani Sadriu jeton në Prishtinë.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të dashur qytetarë,

Uroj që sonte ta përmbyllim këtë seancë me zgjedhjen e presidentes së Republikës së Kosovës, zonjën Vjosa Osmani-Sadriu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Kusari-Lila! Tash kandidatin për president, zotin Nasuf Bejta, e prezanton deputeti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës!
I nderuar Kryeministër i Kosovës,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar përfaqësues diplomatikë të akredituar në Kosovë,
Të nderuara media,
Kam nderin që të prezantoj biografinë e shkurtër të Nasuf Bejtës.

Nasuf Bejta lindi më 3 nëntor 1960, në fshatin Smrekovnicë të Vushtrrisë. Shkollën fillore e kreu në Smrekovnicë, ndërsa të mesmen në gjimnazin “Muharrem Bekteshi”, në Vushtrri. Studimet universitare i kreu në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës. Është inxhinier i diplomuar me përvojë 32-vjeçare në arsim. Aktualisht punon si mësimsdhënës në shkollën e mesme teknike “Lutfi Maliqi”, në Vushtrri. Është veprimtar i hershëm politik dhe bashkëpunëtor civil ushtarak gjatë luftës së fundit. Nasuf Bejta është edhe njëri ndër themeluesit e Degës së LDK-së në Vushtrri, si dhe në zgjedhjet e fundit ishte kandidat për deputet në radhët e koalicionit ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Listës Vjosa, ai garoi me numrin 64. Sot, Nasufi është kandidat për president. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Avdyli! Për verifikimin e kushteve të kandidatëve të nominuar për president, propozoj që Kuvendi të autorizojë Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë së Korrupsionit. I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për autorizimin e këtij komisioni.

Kush është për? Kush është kundër? Nuk ka kundër! Kush abstenon? Nuk ka abstenime!

Në ndërkohë ju njoftoj që kuorumi ka shkuar në 84 deputetë që marrin pjesë në këtë seancë. Kërkoj nga Administrata që të ma japin rezultatin e saktë.

Me 66 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim krijohet, pra aktualizohet autorizimi që ta marrë punën Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për verifikimin e kushteve të kandidatëve të nominuar për president. Kërkoj nga ky komision që menjëherë të mblidhet në sallën N10 të Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin e tij. Për këtë duhet të marrim një pauzë prej rreth 15 minutave.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Deputetë të nderuar, ju lutem, zini vendet!

E ftoj kryetarin e komisionit, zotin Adnan Rustemi, që ta paraqesë raportin.

ADNAN RRUSTEMI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Ambasadorë të akredituar,

Komisioni për Legjislacion pas verifikimit të dokumentacionit paraqet raportin për verifikimin e kushteve të kandidatëve të nominuar për president të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në pajtim me vendimin e mbledhjes plenare, datë 3 prill 2021, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2021 shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të nominuar për president të Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu dhe zotin Nasuf Bejta, në lidhje me plotësimin e kushteve të parapara me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës, për t'u zgjedhur President i Republikës së Kosovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konstatoi se kandidatët e nominuar për president të Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu dhe zoti Nasuf Bejta, i plotësojnë kushtet e parapara me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës për t'u zgjedhur President i Republikës së Kosovës. Prandaj, mund të procedohet me votimin e kandidatëve të nominuar për President të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet i nderuar!

Tash është radha që të shprehen përfaqësuesit e grupeve parlamentare, nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka Mimoza Kusari-Lila, urdhëro!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Ne propozojmë që të procedohet me procesin e votimit për kandidatët për president të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës, zoti Enver Hoxhaj!

ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar ambasadorë të pranishëm në këtë seancë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Zgjedhja presidentit të vendit çdoherë është një ngjarje feste për popullin dhe për shtetin tonë, meqë kjo ndodh një herë në pesë vjet dhe ju, deputetë të nderuar, si përfaqësues të popullit e zgjidhni shefin e shtetit, komandantin suprem dhe unifikuesin e popullit. Për shkak të kësaj rëndësie që ka presidenti në republikën tonë, edhe Kushtetuta jonë parasheh që të ketë një proces të dialogut, të konsultimeve, të pjesëmarrjes të shumicës së partive politike, atë 2/3 e shenjtë në procesin e votimit të presidentit. Duhet të arrihet një kompromis i gjerë me qëllim që presidenti që zgjidhet të jetë sa më konsensual, sa më përfaqësues i shoqërisë.

Që të arrihet një gjë e tillë unë kam takuar Kryeministrin Kurti dhe zonjën Osmani, por një gjë duhet ta dinë qytetarët e Kosovës që nuk ka pasur kurrfarë interesimi, as për konsensus politik, as për konsensus shoqëror, as partiak. Po më shumë ka pasur një logjikë dhe politikë të nënshtrimit dhe jo një politikë të kompromisit politik se si të zgjidhet presidenti në vend. Dhe, kësaj qasje ne si Parti Demokratike i themi “jo”, i kemi thënë “jo” atë ditë dhe sot i themi “jo” dhe prania e zotit Hamza si nënkryetar i Kuvendit dhe imja është më shumë për ta thënë qëndrimin tonë. Dje ne kishim një dramë në Kuvend të Kosovës, e cila ishte një dramë e turpër, me një përpjekje për ta sjellë një ligj të zgjedhjeve dhe ishte një kërcënim, ishte një shantazh për zgjedhje me kartën e zgjedhjeve të parakohshme nëse Kuvendi i Kosovës nuk do ta votonte presidentin. Ishte një përpjekje për ta ngufatur demokracinë në Kosovë, duke abuzuar me numra.

Edhe pse zgjedhja e presidentit është një ngjarje feste, sot këtë seancë ne e shohim si një seancë të poshtërimit, sepse sot zoti Kurti ka vendosur ta emërojë zonjën Osmani si presidente, Vjosa Osmani nuk po zgjidhet si presidente, atë po e emëron zoti Kurti dhe zoti Kurti po e dërgon zonjën Osmani në Presidencë me një qëllim që të ketë një kontroll absolut mbi institucionet e pavarura, mbi gjyqësorin, mbi ushtrinë, mbi Shërbimin Inteligjent, mbi shërbimin e jashtëm, sikurse që ka kontrollin e plotë edhe mbi këtë Kuvend, edhe mbi vetë Qeverinë, sepse në fund të ditës kështu është se si zoti Kurti e sheh shtetin dhe shoqërinë kosovare në përputhje me parullën që e kemi dëgjuar në fushatë zgjedhore, “Krejt dhe drejt”.

“Krejt dhe drejt” duhet t’i binden zotit Kurti. Çfarë mendon për shtetin ai, çfarë mendon për shoqërinë, individin, çfarë mendon se si duhet të zgjidhet edhe presidenti sot, mjerisht më duhet ta them nuk i ngjan një demokrati, më shumë i ngjan një autokrati dhe kjo demokraci po shndërrohet gradualisht në autokraci, këtë do ta kundërshtojë Partia Demokratike dhe këtë do ta bëjmë edhe sot. Albin, nuk e di vaksinën që e ke marrë ndaj COVID-it a ta ka rritur temperaturën apo ka efekte anësore, kur dje në mëngjes flisje për zgjedhje, në mbrëmje flisje për zgjedhje, sot me status në Facebook prapë flisje për zgjedhje, a vendi ka nevojë për lidhshmëri, për ta nxjerrë këtë vend prej krizave, edhe shëndetësore, ekonomike dhe, mbi të gjitha një aspekt që s’po e përmendim një brez i cili po humb për shkak të mësimin online dhe pandemisë. Unë sot i them

zotit Kurti, dhe i drejtohem përsëri me Albin, mund ta gjesh kë të duash në këtë Kuvend për ta shantazhuar, por nuk e shantazhon Partinë Demokratike të Kosovës, PDK-ja kësaj i thotë “jo”.

Shantazhet nuk shiten në PDK. Ne më shumë preferojmë zgjedhje që ta ruajmë dinjitetin, se sa të bëhemi pjesë e këtij teatri politik dhe kësaj drame, e cila po luhet në dy pjesë. Pjesën e parë e keni parë dje, pjesën e parë po e shihni sot, ku zoti Kurti jep urdhra si regjisor dhe të tjerët i binden edhe ju në këtë sallë po i bindeni, natyrisht ju çka jeni me zotin Kurti është në rregull, por këta çka janë në opozitë, duhet ta mendojnë këtë çështje.

Partia Demokratike e Kosovës ka arsye parimore dhe unë i kam thënë disa herë, ia kam thënë edhe zonjës Osmani pse ne nuk e mbështesim zonjën Osmani që të jetë presidente e vendit, se tema kryesore kush duhet të jetë president është e rëndësishme, sepse nuk është figurë unifikuese, është përçarëse, sepse është figurë partiake dhe sot po e votoni një presidente partiake jokonsensuale, sepse i mungon pavarësia politike dhe do të jetë komplet nën diktatin e zotit Kurti.

Po përtej kësaj çka kemi thënë deri më tash, më lejoni t’i kthehem asaj çfarë ndodhi dje. Dje ka pasur një situatë, ku nëse zonja Osmani, ia kam thënë Vjosës, do të tregonte integritet në emër të mbrojtjes të ligjit, iniciativës ligjore, ne në Partinë Demokratike të Kosovës e kemi pasur ndërmend seriozisht të reflektojmë, por nuk tregoi integritet. Prandaj, dje u pa që nuk ka parime, po ka vetëm kalkulime, të jesh dje pjesë e shantazhit të opozitës me zgjedhje të reja dhe të kërkosh votën sot, nuk shkon. Ne çka jemi në politikë, të paktën në situata të tilla duhet ndjekur ndërgjegjen nëse jo politike, nganjëherë ndërgjegjen tonë personale dhe unë kam pritur dje prej zonjës Osmani, sikurse e njoh që e ndjek ndërgjegjen personale, gjë që s’e ka bërë një gjë të tillë.

Prandaj, të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës nuk e voton zonjën Osmani, ne e shohim këtë seancë vetëm si një përpjekje për një super kapje të shtetit nga një person i vetëm dhe një rikthim në monizëm. Mua më vjen keq dhe natyrisht që e kam në konsideratë, po dua të shpreh keqardhje se si një parti politike si LDK-ja që origjinën dhe misionin e saj e kishte në përmbysje të monizmit në vitet e ‘90-ta, sot me qëndrimin që e ka po e rikthejnë një parti shtet për herë të parë, ku janë të koncentruar tri rolet kryesore të pushtetit në duart e një njeriu.

Partia Demokratike e Kosovës nuk e tradhton qytetarin, ne e mbrojmë dinjitetin para nënshtrimit, parimet para shantazhit dhe ne prej sodit jemi opozita e vërtetë, juve ju bëj për hair koalicionin e ri që e keni dhe jeni në shumicë edhe më absolute tash bashkë me LDK-në dhe bashkë me kolegët e tjerë, ju dëshiroj sukses.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hoxhaj! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës? Nuk e do fjalën askush! Lista serbe mungon, nuk është në Kuvendin e Kosovës, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk e do fjalën askush, nga Grupi Parlamentar Multietnik, zoti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Sayın Başbakan

Değerli Bakanlar

Çok Irklı Parlamento Grubu, belediye başkanını seçme prosedürüne destekliyor. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kervan!

I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për emërimin e anëtarëve, vetëm disa sqarime para kësaj. Ju njoftoj, të nderuar deputetë, me procedurën për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës sipas nenit 86 të Republikës së Kosovës. Janë disa sqarime ndoshta pak të gjata, por janë të nevojshme para se të hyjmë në procesin e votimit.

Presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet me votim të fshehtë. Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës gjatë tri votimeve duhet të ketë më shumë se një kandidat. Presidenti i Republikës së Kosovës në votimin e parë dhe të dytë zgjidhet me 2/3 të të gjithë deputetëve të Kuvendit, pra me 80 vota për. Në votimin e tretë Presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, pra të paktën 61 vota për.

Tash tri sqarime, si në vijim: në votimin e parë duhet të marrin pjesë të paktën 80 deputetë dhe në relacion me këtë që e thashë, nëse në votim marrin pjesë më pak se 80 deputetë, konsiderohet se nuk ka kuorum për vendimmarrje, andaj duhet të përsëritet votimi i parë. Dhe, po ashtu, në relacion me këtë nëse në votimin e parë kanë marrë pjesë së paku 80 deputetë, mirëpo asnjë kandidat nuk i merr votat e nevojshme, pra të paktën 80 vota për, atëherë organizohet votimi i dytë. Në votimin e dytë duhet të marrin pjesë të paktën 80 deputetë dhe në këtë aspekt nëse në votim marrin pjesë më pak se 80 deputetë, konsiderohet se nuk ka kuorum për vendimmarrje, andaj duhet të përsëritet votimi i dytë.

Kurse, nëse në votimin e dytë kanë marrë pjesë së paku 80 deputetë, mirëpo asnjëri kandidat nuk i merr votat e nevojshme, të paktën 80 vota për, atëherë organizohet votimi i tretë. Dhe, në votimin e tretë duhet të marrin pjesë së paku 61 deputetë. Në relacion me këtë nëse në votim marrin pjesë më pak se 61 deputetë, konsiderohet se nuk ka kuorum për vendimmarrje, andaj duhet të përsëritet votimi i tretë, kurse nëse në votimin e tretë asnjëri nga kandidatët nuk i merr votat e nevojshme, pra të paktën 61 vota për, atëherë shpërndahet Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Meqë zgjedhja e presidentit bëhet me votim të fshehtë, kjo nënkupton krijimin e një komisioni votues nga përbërja e deputetëve me mbështetje të zyrtarëve të Administratës. Andaj, para se të

procedojmë me votimin e fshehtë, i ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin për organizimin e votimit të Presidentit të Republikës së Kosovës. Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e merr Mimoza Kusari-Lila, urdhëroni!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje i propozuar është deputeti Salih Zyba.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së nuk është në sallë. Grupi Parlamentar i LDK-së? Arben Gashi e ka fjalën, urdhëroni zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Grupi Parlamentar i LDK-së e propozon deputetin Besian Mustafa.

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Lista serbe askush nuk është në sallë. Nga AAK-ja nuk ka propozime. Nga Grupi Multietnik, fjalën e ka Enis Kervan. Urdhëroni!

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Nga Grupi Parlamentar Multietnik e propozojmë deputeten Duda Balje.

KRYETARI: Faleminderit! Meqë i kemi të gjithë emrat e propozuar dhe po konstatoj që në sallë janë 82 deputetë të pranishëm, atëherë deputetët me ngritje dore të deklarohen për emërimin e anëtarëve të Komisionit për organizimin e votimit.

Kush është për? Mirë! Kush është kundër? Nuk ka! Kush abstenon? Nuk ka asnjë abstenim.

Konstatoj që me 69 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit për organizimin e votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim së pari le t'i zënë vendet anëtarët për të cilët u votua dhe pas kësaj, i ftoj deputetët e pranishëm sipas listës që e kemi të Kuvendit të Republikës së Kosovës për t'i marrë fletëvotimet dhe për t'u realizuar votimi i fshehtë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci)

KRYESUESJA: Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Alban Bajrami, Alban Hyseni, Albana Bytyqi.

Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arjeta Rexhepi, Arjeta Fejza.

Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralia, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Bedri Hamza, Behgjet Pacolli, Bekë Berisha.

Bekim Arifi, Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Branislav Nikoliq, Burim Karameta, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili.

Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enes Kervan, Enver Dugolli.

Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi, Fadil Gashi, Fadil Nura, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri.

Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Gramoz Agusholli.

Hajdar Beqa, Haki Abazi, Haxhi Avdyli, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ivan Todosijeviq, Jahja Kokaj, Jasmina Dediq, Jeta Statovci.

Jetmire Vrenezi, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Lubinko Karaxhiq, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku, Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku.

Milazim Salihaj, Miljana Nikoliq, Milosh Peroviq, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Sadiku, Mirsad Shkreta, Njazi Isaku, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Rrezarta Krasniqi.

Salih Zyba, Samra Iljas, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Slavko Simiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Uran Ismaili.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vafije Blair, Vendenis Lahu, Verica Ceraniq, Visar Korenica, Vjosa Osmani-Sadriu, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Zoran Mojsiloviq dhe Glauk Konjufca.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Dhe, në fund, Saranda Bogujevci.

Në ndërkohë ftoj ndonjë deputet, i cili mund të ketë ardhur eventualisht në ndërkohë, që ta marrë fletëvotimin dhe të votojë. Nëse nuk ka të tjerë, mund të them se konstatohet që mbyllet votimi për votimin e parë.

E ftojme pas kësaj komisionin, që ta përpilojë e ta paraqesë raportin. Atëherë, ftojmë komisionin nëse është i gatshëm. Ju lutem!

SALIH ZYBA: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Komisionit konstatoj se në proces të votimit kanë marrë pjesë 78 deputetë. Kështu që, mbetet me i vendos procedurat ju. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuari deputet!

Atëherë, në pajtim me atë që lexuam në fillim si rregull është që, kemi thënë pra, se nëse në votim marrin pjesë më pak se 80 deputetë, konsiderohet se nuk ka kuorum për vendimmarrje. Andaj, duhet të përsëritet votimi i parë. Propozoj që përsëritja e votimit të parë të ndodhë brenda 10 minutash, ose menjëherë nëse është e gatshme Administrata. Atëherë, menjëherë.

Atëherë, të nderuar deputetë, zini vendet ju lutem! Deputetë të Vetëvendosjes, a mund të uleni? Administrata më lajmëron që Komisioni është i gatshëm për punë. Ne do të shkojmë në përsëritjen e votimit të parë. Thërras emrat e deputetëve, secilin me radhë dhe sipas alfabetit:

Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Alban Bajrami, Alban Hyseni, Albana Bytyqi.

Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arjeta Rexhepi, Arjeta Fejza.

Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralia, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Bedri Hamza, Behgjet Pacolli, Bekë Berisha.

Bekim Arifi, Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Branislav Nikoliq, Burim Karameta, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili.

Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enes Kervan, Enver Dugolli.

Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi, Fadil Gashi, Fadil Nura, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri.

Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Gramoz Agusholli.

Hajdar Beqa, Haki Abazi, Haxhi Avdyli, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ivan Todosijeviq, Jahja Kokaj, Jasmina Dediq, Jeta Statovci.

Jetmire Vrenezi, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Lubinko Karaxhiq, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku, Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku.

Milazim Salihaj, Miljana Nikoliq, Milosh Peroviq, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Sadiku, Mirsad Shkreta, Njazi Isaku, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Rrezarta Krasniqi.

Salih Zyba, Samra Iljas, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Slavko Simiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Uran Ismaili.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vafije Blair, Vendenis Lahu, Verica Ceraniq, Visar Korenica, Vjosa Osmani-Sadriu, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Zoran Mojsiloviq...

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci)

SARANDA BOGUJEVCI: Dhe, Glauk Konjufca.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Meqë na ndodhi që në rundin e kaluar një deputete erdhi pas votimit, i thërras të gjithë deputetët që mund të ndodhen eventualisht jashtë sallës ku po votojmë, që të vijnë e të votojnë nëse këtë nuk e kanë bërë deri tash. Presim dy minuta.

Faleminderit! Konstatoj të mbyllur këtë përsëritje të votimit të parë. E ftoj komisionin e ngarkuar që të na prezantojë rezultatet e votimit.

Urdhëroni komisioni! Faleminderit!

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Pas numërimit të dyfishtë konstatojmë, se në votim kanë marrë pjesë 79 deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tash na duhet një konsultë e shkurtër.

Siç e patë, komisioni i ngarkuar e shpalli rezultatit. Me 79 vota në kuti të votimit, që i bie se sërish nuk është konsumuar rundi i parë dhe që ai duhet të përsëritet. Për një vendim lidhur me vazhdimin e kësaj seance ju njoftojmë pas një pauze 30 minutash. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Të nderuar deputetë,

Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje gjatë votimit të përsëritur të rundit të parë për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, seanca do t'i vazhdojë punimet nesër, më 4 prill 2021, në orën 17:00. Faleminderit! Mirupafshim!

E diel, më 4 prill 2021

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 3 prill 2021

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

I nderuar Kryeministër,

Zëvendësministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar ambasadorë të vendeve mike në Kosovë,

Së pari një urim i përzemërt për të gjithë besimtarët katolikë dhe protestantë, Urime Pashkët!

Paçim të gjithë fat, shëndet e lumturi!

I vazhdojmë punimet e seancës së jashtëzakonshme, e filluar më 3 prill 2021 për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Kandidatë zyrtarë në dominuar janë: Vjosa Osmani-Sadriu dhe Nasuf Bejta

Më lejoni që t'ju kujtoj rëndësinë e respektimit të masave për mbrojtje nga pandemia COVID-19, duke u bazuar në manualin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe rekomandimet e IKSHPK-së, përgjatë seancës është i obliguar përdorimi i maskave nga secili.

Në sallë konstatoj se janë të pranishëm 83 deputetë të Kuvendit të Kosovës. Konstatoj se kemi kuorum të mjaftueshëm për të proceduar. Vazhdojmë me votimin e parë. Mund të themi me përsëritjen e rundit të parë, në mungesë të kuorunit për vendimmarrje në rastet e mëhershme për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

E lus Komisionin që ta fillojë punën menjëherë. Në ndërkohë, konstatoj sa se i përket kuorunit janë 84 deputetë në sallë. Komisioni është gati. Në vazhdim i ftoj deputetët sipas listës për ta marrë fletëvotimin dhe për ta realizuar votimin e fshehtë për zgjedhjen e Presidentes:

Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Alban Bajrami, Alban Hyseni, Albana Bytyqi.

Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arjeta Rexhepi, Arjeta Fejza.

Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralia, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Bedri Hamza, Behgjet Pacolli, Bekë Berisha.

Bekim Arifi, Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Branislav Nikoliq, Burim Karameta, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili.

Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enes Kervan, Enver Dugolli.

Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi, Fadil Gashi, Fadil Nura, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri.

Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Gramoz Agusholli.

Hajdar Beqa, Haki Abazi, Haxhi Avdyli, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ivan Todosijeviq, Jahja Kokaj, Jasmina Dediq, Jeta Statovci.

Jetmire Vrenezi, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Lubinko Karaxhiq, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku, Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku.

Milazim Salihaj, Miljana Nikoliq, Milosh Peroviq, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Sadiku, Mirsad Shkreta, Njazi Isaku, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Rrezarta Krasniqi.

Salih Zyba, Samra Iljas, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Slavko Simiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Uran Ismaili.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vafije Blair, Vendenis Lahu, Verica Ceraniq, Visar Korenica, Vjosa Osmani-Sadriu, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Zoran Mojsiloviq dhe Glauk Konjufca.

Faleminderit!

Nëse eventualisht ndonjë deputet ende nuk ka votuar, pas Salih Zybës e kam fjalën dhe Besianit. Presim edhe pak, ashtu që çdonjëri të mund ta shfrytëzojë të drejtën e votës.

E shpalli të mbyllur këtë proces të votimit dhe i ftoj anëtarët e Komisionit të votimit që të na njoftojnë me rezultatin.

Regjia, ia kaloni fjalën anëtarit të Komisionit.

SALIH ZYBA: Faleminderit, kryetar!

Po vazhdojmë me numërim.

KRYETARI: Ju lutem, na tregoni fillimisht se sa deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë votuar.

SALIH ZYBA: Po. Në votim kanë marrë pjesë 81 deputetë. Rrjedhimisht në kuti ndodhen 81 vota. Nëse më lejoni mund të vazhdoj me numërim.

KRYETARI: Mirë mund të vazhdoni të na e tregoni rezultatin e votimit.

SALIH ZYBA: Faleminderit!

E pavlefshme.

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme,

E pavlefshme,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme,

Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Dhe e fundit Vjosa Osmani-Sadriu.

BESIAN MUSTAFA: Atëherë konstatojmë se në votim kanë marrë pjesë 81 deputetë. Të pavlefshme janë 12 fletëvotime. Për Vjosa Osmani-Sadriun kanë votuar 69 deputetë, për z. Nasuf Bejta kanë votuar zero deputet. Prandaj konstatojmë se asnjëri prej kandidatëve nuk ka marrë votat e mjaftueshme në votimin e parë.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Pas zhvillimit të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, në vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 4 prill 2021 në votimin e parë konstatoj:

Në votim kanë marrë pjesë 81 deputetë. Të pavlefshme janë 12 fletëvotime.

Për znj. Vjosa Osmani-Sadriu kanë votuar 69 deputetë, për z. Nasuf Bejta kanë votuar 0 deputet.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, konstatoj se nuk është zgjedhur asnjëri kandidat për President të Republikës së Kosovës.

Kështu që kalojmë në rundin e dytë. Administrata më thonë që janë të përgatitur që menjëherë të procedojmë me rundin e dytë. Gjithçka është gati.

Atëherë po i thërras sipas rendit deputetët e pranishëm që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votës:

Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Alban Bajrami, Alban Hyseni, Albana Bytyqi.

Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arjeta Rexhepi, Arjeta Fejza.

Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralia, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Bedri Hamza, Behgjet Pacolli, Bekë Berisha. Bekim Arifi.

Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Branislav Nikoliq, Burim Karameta, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili.

Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enes Kervan, Enver Dugolli.

Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi, Fadil Gashi, Fadil Nura, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri.

Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Gramoz Agusholli.

Hajdar Beqa, Haki Abazi, Haxhi Avdyli, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ivan Todosijeviq, Jahja Kokaj, Jasmina Dediq, Jeta Statovci.

Jetmire Vrenezi, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Lubinko Karaxhiq, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku, Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku.

Milazim Salihaj, Miljana Nikoliq, Milosh Peroviq, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Sadiku, Mirsad Shkreta, Njazi Isaku, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Rrezarta Krasniqi.

Salih Zyba, Samra Iljas, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Slavko Simiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Uran Ismaili.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vafije Blair, Vendenis Lahu, Verica Ceraniq, Visar Korenica, Vjosa Osmani-Sadriu, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Zoran Mojsiloviq dhe Glauk Konjufca.

Faleminderit!

E shpall të mbyllur këtë proces të votimit dhe e ftoj Komisionin e votimit që të na e prezantojë rezultatin. Komisioni e ka fjalën.

SALIH ZYBA: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Komisionit konstatojmë se në proces të votimit kanë marrë pjesë 82 deputetë, rrjedhimisht edhe ndodhen 82 vota në kuti. Nëse mund të vazhdojmë me numërim?

KRYETARI: A mund të vazhdoni me rezultatin?

SALIH ZYBA: Po!

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme

Vjosa Osmani-Sadriu,

E Pavleshme

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Kolegia jonë anëtar i Komisionit ka kërkesë të fillojmë prej fillimit, për shkak të saktësisë. Me mirëkuptim, ne e rifillojmë numërimin.

KRYETARI: Çfarë saktësie ju lutem?

SALIH ZYBA: Në evidencë, në numërim. Në proces. Nuk ka dyshime të tjera, pos që nuk ka mundur t'i mbajë në evidencë.

KRYETARI: Dakord, fillojeni numërimin e votave nga fillimi.

SALIH ZYBA:

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme

E pavlefshme

Vjosa Osmani-Sadriu,

E pavlefshme

Kërkoj falje, është e pavlefshme edhe kjo.

Nasuf Bejta,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
E pavlefshme,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Nasuf Bejta,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Nasuf Bejta,
Vjosa Osmani-Sadriu,
E pavlefshme,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
E pavlefshme,
Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Nasuf Bejta,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Dhe e fundit: Vjosa Osmani-Sadriu.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Na e sillni tash rezultatin e kandidatëve.

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë. Të pavlefshme janë 11 fletëvotime. Për znj. Vjosa Osmani-Sadriu kanë votuar 67 deputetë, për z. Nasuf Bejta kanë votuar 4 deputetë. Prandaj, konstatojmë se asnjëri prej kandidatëve nuk ka marrë votat e duhura as në rundin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Pas zhvillimit të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendi tepër zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, në vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 4 prill 2021, në votimin e dytë konstatohet që:

Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë. Vota të pavlefshme janë 11. Për znj. Vjosa Osmani-Sadriu kanë votuar 67 deputetë, kurse për z. Nasuf Bejta kanë votuar 4 deputetë.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 27 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet që në rundin e dytë nuk është zgjedhur asnjëri kandidat për President të Republikës së Kosovës.

Prandaj, kalojmë në rundin e tretë dhe të fundit të votimit për President të Republikës së Kosovës.

I lus Administratën që të më tregojnë nëse janë gati për proces? Ata ma pohojnë. Kështu që vazhdojmë me rundin e tretë. Komisioni është gati.

I thërrasim të gjithë deputetët që eventualisht nuk ndodhen në sallë. Ju lutem deputetë, uluni!

Konstatohet që 80 deputetë janë të pranishëm. Fillojmë me procesin e votimit në rundin e tretë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Tash do t'ju thërras me emra secilin prej jush, në mënyrë që të mund të votoni:

Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Alban Bajrami, Alban Hyseni, Albana Bytyqi.

Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arjeta Rexhepi, Arjeta Fejza.

Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralia, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Bedri Hamza, Behgjet Pacolli, Bekë Berisha.

Bekim Arifi, Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Branislav Nikolij, Burim Karameta, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili.

Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enes Kervan, Enver Dugolli.

Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi, Fadil Gashi, Fadil Nura, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri.

Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Gramoz Agusholli.

Hajdar Beqa, Haki Abazi, Haxhi Avdyli, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ivan Todosijeviq, Jahja Kokaj, Jasmina Dediq, Jeta Statovci.

Jetmire Vrenezi, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Lubinko Karaxhiq, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku, Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku.

Milazim Salihaj, Miljana Nikoliq, Milosh Peroviq, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Sadiku, Mirsad Shkreta, Njazi Isaku, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Rrezarta Krasniqi.

Salih Zyba, Samra Iljas, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Slavko Simiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Uran Ismaili.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vasfije Blair, Vendenis Lahu, Verica Ceraniq, Visar Korenica, Vjosa Osmani-Sadriu, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Zoran Mojsiloviq...

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Dhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Deputetë, ju lutem t'i zini vendet tuaja!

E shpalli të mbyllur procesin e votimit në rundin e tretë për Presidenten e Republikës së Kosovës.

Kurdo që komisioni është i përgatitur mund të na e prezantojë rezultatin. Komisioni e ka fjalën.

SALIH ZYBA: Faleminderit, kryetar!

Në emër të komisionit konstatojmë se në proces të votimit kanë marrë pjesë 82 deputetë. Rrjedhimisht, saktësisht ndodhën 82 vota prezent. Në mund të fillojmë me numërimin ju lutem!

KRYETARI: Po, lirisht! Urdhëroni!

SALIH ZYBA:

E pavlefshme,
Vjosa Osmani-Sadriu,
Vjosa Osmani-Sadriu,

Vjosa Osmani-Sadriu dhe
Vjosa Osmani-Sadriu,

KRYETARI: Ju lutem, ta mbyllim procesin!

SALIH ZYBA: Faleminderit, kryetar!

(Duartrokitje)

KRYETARI: E lus komisionin që nëse është i përgatitur, të fillojë me procesin e prezantimit të rezultatit të votimit.

DUDA BALJE: Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë. Të pavlefshme kanë qenë 11 vota.

Për zonjën Vjosa Osmani- Sadriu kanë votuar 71 deputetë.

Për zotën Nasuf Bejta kanë votuar zero deputet.

Komisioni konstaton se kandidatja, zonja Vjosa Osmani-Sadriu ka marrë vota të mjaftueshme që të jetë Presidente e Republikës së Kosovës. Urime!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Bazuar në raportin që e prezantoi komisioni, konstatoi që Kuvendi i Republikës së Kosovës e zgjodhi Presidente të Republikës së Kosovës, zonjën Vjosa Osmani-Sadriu.

(Duartrokitje)

E ftoj Presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Vjosa Osmani-Sadriu që ta bëj betimin para deputetëve të Kuvendit.

PRESIDENTJA VJOSA OSMANI-SADRIU: *Betohem se tërë fuqinë time do t'ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, sigurimit të lirive dhe të drejtave njerëzore e qytetare, respektimit dhe mbrojtjes së Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjes së paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, dhe me ndërgjegje e përgjegjësi do t'i kryej të gjitha detyrimet e mia. Betohem!*

KRYETARI: Zonja presidente, nëse mund t'ju lus diçka?! Për hir të rendit që e kemi, ju ftoj ta zini vendin ku ishit më parë, tua urojmë së bashku me kryeministrin, pastaj do ta lëshojmë himnin shtetërorë të Republikës së Kosovës, dhe do t'ju ftoj për ta thënë një fjalë rasti.

Në vazhdim do ta intonojmë himnin shtetëror të Republikës së Kosovës.

(Intonimi i himnit shtetëror)

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
E ftoj presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Vjosa Osmani-Sadriu, që ta paraqesë fjalën e saj të rastit. Urdhëroni zonja presidente!

PRESIDENTJA VJOSA OSMANI-SADRIU: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca,
Zonja nënkryetare, zonja Bogujevci,
I nderuar kryeministër, zoti Kurti,
Zëvendëskryeministra e ministra të kabinetit qeveritar,
Shumë të dashur kolegë të deritanishëm, deputetë të Legjislaturës së VIII,
Të nderuar mysafirë të pranishëm,
Përfaqësues të vendeve mike,
Miq tanë të dashur që kurrë nuk na u ndatë,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve të sigurisë,
Të dashur përfaqësues të medieeve, faleminderit për durimin dhe pjesëmarrjen,
Fort të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
E ju mërgatë e dashur,

Është nder i madh për mua që me bekimin tuaj, e mbi të gjitha me vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, t'ju drejtohem nga foltorja e këtij Kuvendi, në cilësinë e presidentes së sapo zgjedhur të vendit tonë, dhe tua shpreh mirënjohjen time të thellë dhe përluljen para besimit tuaj që ta drejtoj vendin në pesë vitet e ardhshme.

Vullneti juaj qytetar të nderuar, i shprehur më 14 shkurt, si dhe vendimi i sotëm i Kuvendit, përpos që më bëjmë nderin më të madh jetësor, më veshin njëkohësisht me shumë përgjegjësi.

Dashuria për Kosovën, vendin tonë dhe për bashkëvendësit tanë, ka qenë motivimi më i madh në çdo hap të jetës sime politike dhe do të vazhdojnë të jenë udhërrëfyesi im përherë.

Sot është dita e Kosovës, është dita e juaj. Është ditë në të cilën vullneti juaj të dashur qytetarë, i shprehur më 14 shkurt, po plotësohet dhe në të cilën institucionet e vendit të dala nga ky vullnet po konstituohen plotësisht. Është dita e Kosovës, sepse përfaqësuesit tuaj të zgjedhur, duke e respektuar plotësisht vullnetin tuaj, sot jo vetëm se po e përmbyllin dinjitetshëm një kaptinë të zgjedhjeve demokratike, por po e vulosin edhe njërin ndër shembujt më të mirë të funksionimit të demokracisë duke respektuar në plotëni vullnetin e qytetarëve të tyre.

Është dita në të cilën ne dëshmojmë edhe një herë, sikurse shumë herë në historinë tonë, se me urti e vendosmëri, ne dimë t'i përballojmë sfidat dhe t'u japim atyre kuptim.

Në këtë ditë, përkushtimi juaj po jetësohet dhe vendosmëria e juaj që ta realizoni ëndrrën tuaj, ta rrisni e ta zbukuroni atë me besim të pathyer në të ardhmen, po jetësohet.

Sot, po e përmyllim parathënin e historisë së re të politikës në shtetin e Kosovës, që filloi të shkruhet më 14 shkurt e 22 mars, për t'i hapur rrugët kapitullit të parë të sukseseve, të cilin do ta shkruajmë të gjithë së bashku.

Të dashur qytetarë të Republikës,

Sot, Kosova e zgjodhi edhe njëherë presidente grua, dhe për të gjitha vajzat e vogla që mund të jenë duke na shikuar në këto momente, shpresoj që ju përherë ta mbani në mendje këtë që po e them tani; vajzat e kanë vendin vetëm aty ku ato vet dëshirojnë, aty ku ato çdo natë ëndërrojnë, aty për çka ato punojnë fort e me zell.

Pa marrë parasysh, nëse ëndëroni të bëheni presidente, juriste, mjeke, ndërmarrëse, inxhinierë, police, ushtarë apo çfarëdo profesioni tjetër që ua do zemra e për të cilinën punoni, mos u ndalni, mos e ndalni hapin tuaj kurrë.

Çdo gjë është e mundur, e çdo ëndërr e juaja mund të bëhet realitet dhe për këtë duhet të besojmë bashkë fort.

Gjersa ju udhëtoni nëpër etapa të ndryshme të jetës suaj drejt majave, unë do t'ju shoh me admirimin, do t'ju mbështesë me të gjitha mundësitë që kam e me tërë qenien time. Do të brohoras çdo arritje tuajën. Do t'ju përkrah e do të jem pranë jush kur të sfidoheni, e do të krenohem aq fort sa herë që ju do të triumfoni.

Në ditë si kjo gëzohem shumë për faktin që shembulli që po jep Republika jonë, me përfaqësimin e gruas në nivel institucional, qoftë në Presidencë, Qeveri apo Kuvend, është model për t'u ndjekur edhe nga disa prej demokracive më të konsoliduara.

Institucionet e vendit tonë, gjithnjë e më shumë po reflektojnë strukturën e shoqërisë sonë, e historinë tonë të larmishme, por kemi edhe shumë punë përpara.

Të nderuar të pranishëm,

Ne nuk kemi nevojë të shohim as përtej kësaj sale për t'i kuptuar vuajtjet e tmerrshme të popullit tonë, e sakrificat e shumta nëpër të cilat kaluam si popull shqiptar, bashkë edhe me kombësitë e tjera që sot janë këtu prezent.

Historia jonë është historia edhe e njerëzve përfaqësues të ulur në këtë sallë. Është historia e të mbijetuarës së dhunës seksuale gjatë luftës, e cila është ulur në radhën e parë të kësaj sale. Zonja

Krasniqi është vetë historia jonë, është dhimbja e përbashkët, por mbi të gjitha është simbol i forcës sonë, i forcës së popullit tonë.

Në anën tjetër, nënkryetare të Kuvendit kemi zgjedhur bashkërisht, të mbijetuarën e masakrës ndaj familjeve Bogujevci e Duriqi, një ndër masakrat e shumta ndaj popullit tonë, grua e cila simbolizon rilindjen e shpresës e të qëndresës, e mbi të gjitha, të misionit për të treguar të vërtetën.

Në Qeveri, sot, kemi ministra që kanë mbijetuar masakrën e Dubravës dhe para të gjithë neve, tregojnë se janë simbol i mosdorëzimit para asnjë sfide.

Donika, vajza e heroit Jusuf Gërvalla, është vënë në krye të Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës, për të dëshmuar fatin tonë të përbashkët me mërgimtarët tanë, të cilët përfaqësohen edhe nga Armendi në Qeveri, nga mërgimtarët të cilët jetojnë me shpirtin e vuarë për mungesën e gjatë të atdheut.

Ata na thërrasin çdo ditë që ta jetësojmë amanetin e heronjve tanë e të punojmë për shtet të së drejtës, e shtet demokratik në të cilin vlerat njerëzore respektohen e promovohen.

Në opozitë kemi deputetë të cilët humbën prindërit edhe pas luftës, vetëm e vetëm pse ata i qëndruan besnikë kauzës për liri, pavarësi dhe demokraci.

Në krye të Qeverisë, ndërkaq sot, është kryeministri ynë, një ish i burgosur politik, që njohu fytyrën e vërtetë të agresorit nëpër kazamatet e egra të një regjimi tepër të egër.

Secili nga ata, e shumë të tjerë sot në këtë sallë, që dhanë më të shtrenjtë e tyre edhe familjarët e tyre, që dhanë mundin, djersën e tyre për liri, sot shpërfaqin një faqe të re të historisë së Kosovës, që është këmbëngulja jonë e përbashkët për ta jetësuar shtetin tonë.

Bashkë që të gjithë ne, e kemi kthyer dhembjen në fuqi për bashkëveprim ndërmjet qytetarëve tanë të cilësdo etni e besim qofshin ata.

Ne jemi fëmijët e prindërve që çdo ditë u zgjuan e çdo natë ranë në gjumë me brengën për vendin ku i rrisnin fëmijët, me brengën se si do t'i shkollojnë kur shkollat mbylleshin, sesi do t'i ushqenin familjet kur ata u larguan dhunshëm nga puna. Me brengën se di do të na mbronin nga një regjim që synonte shfarosjen tonë.

Prandaj, sot secili prej nesh, shprehim mirënjohjen e thellë ndaj prindërve tanë, gjeneratën e sakrificës së madhe për ne.

Ndaj, paraardhësve tanë që përjetuar dhunën më mizore, në mënyrë që ne sot të frymojmë lirshëm e që të mund të flasim po në këtë sallë nga e cila ishin dëbuar përfaqësuesit tanë në vitin 1989.

Sot, Kosova rishtas po e jep shembullin e mirëkuptimit për vlerat e përbashkëta të demokracisë, prandaj edhe sot është dita e Kosovës, dita e demokracisë së saj.

Andaj, më lejoni që në të këtë ditë të veçantë për qytetarët dhe institucionet tona, t'ju ftoj që së bashku t'i kujtojmë dhe tua shprehim mirënjohjen tonë të thellë, të gjithë atyre që kontribuuan që sot ta kemi shtetin tonë.

Ta kujtojmë rolin e ideatorit e projektuesit të pavarësisë së vendit, arkitektin e shtetit tonë, dr. Ibrahim Rugovën, ikonën e përbashkët të lirisë, njeriun e dijeve, i cili politikës ia dha dimensionin më të çmueshëm të saj, dimensionin human.

Historia jonë është histori e përpjekjeve të përbashkëta dhe të qëndruarit fort afër njëri-tjetrit në gaste të gëzimit të madh, por sidomos në ato të sfidave të mëdha.

Historia jonë është histori e përkushtimit dhe sakrificës së paskajshme njerëzore. Prandaj, t'i kujtojmë sot bashkërisht heronjtë tanë, të cilët lirinë e vendit e patën idealin më të çmuar jetësor.

Të kujtojmë trimërinë e jashtëzakonshme, e sakrificën e komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharit, secilin ushtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjithë familjen Jashari, e cila u sakrifikuara për lirinë e vendit, të gjithë dëshmorët e heronjtë, të gjithë të pagjeturit, martirët e shumtë, përfshirë gra, fëmijë e pleq, si dhe të gjithë njerëzit e mirë të këtij vendi që sakrifikuan çdo gjë për lirinë tonë të përbashkët.

Kujtojmë 1133 fëmijët e vrarë gjatë luftës në Kosovë, lulet e bardha të Kosovës që këputen ende pa çelur mirë, me ëndrrën e tyre të fjetur mbi ballë, por që u shndërruan në lulen e lirës sonë, si dhe gratë e burrat e këtij Kuvendi, të cilët e jetësuan vullnetin tonë për të jetuar të pavarur, duke shpallur shtetin më të ri evropian dhe neve, evropianët e vjetër na rikthyen në shtetarët e rinj.

Të nderuar deputetë e shumë të dashur qytetarë,

22 vjet më parë, djemtë dhe vajzat tona u detyruan të luftojnë për çlirim, teksa sot vajzat e djemtë e forcës sonë, janë bërë pjesë e misionit të parë paqeruajtës krahas partnerit tonë strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sot, nga ky vend, ne mendojmë edhe për ata që janë larg shtëpisë e që ndodhen në këtë mision paqësor. Janë ushtarët tanë nga kontingjenti i parë paqeruajtës, të cilët sapo kanë nisur misionin. Ata janë krenaria jonë, ngase nga një vend që përjetoj luftën, ne sot po bëjmë hapa përpara për të dhënë kontribut në paqen globale.

Forca e Sigurisë së Kosovës, ushtria jonë është ushtria më e re në botë që po kalon periudhën e tranzicionit, por është ushtria me besimin më të madh qytetar, dhe pikërisht profesionalizmi dhe besueshmëria e qytetarëve ndaj Forcës së Sigurisë, është garancia më e madhe për sigurinë tonë dhe më gjerë dhe garancia më e madhe për ta realizuar synimin tonë strategjik për anëtarësim në NATO.

Historia jonë krahas dhimbjes është edhe histori e shpresë dhe e ngadhënjimit mbi të keqën, në të cilin rrugëtim e patëm përherë përkrahjen e miqve tanë të shumtë. Ne do t'ju jemi përjetësisht mirënjohës atyre të cilët, jo vetëm që u rreshtuar krahas popullit të Kosovës në synimin e tij për liri e pavarësi, por qëndruan krahas nesh edhe në ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Ne sot kërkojmë nga ata të vazhdojnë të qëndrojnë krahas nesh në synimet tona të përbashkëta për integrim të shpejtë në strukturat euroatlantike, për zhvillim të ekonomisë, për garantim të barazisë dhe për prosperim të përgjithshëm të vendit, e mbi të gjitha të qëndrojnë pranë nesh në mbrojtjen e vlerave të lirisë dhe demokracisë të cilat i ndërtoam bashkë, po i mbrojmë bashkë e do t'i gëzojmë bashkë.

Në mesin e aleatëve tanë të shumtë, janë tri shtylla në të cilat jemi mbështetur fort e na kanë qëndruar pranë gjithnjë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e populli i lirë amerikan, me të cilin ne ruajmë miqësi të hershme dhe të përhershme, Bashkimi Evropian e Mbretëria e Bashkuar.

Bashkimi Evropian, anëtarësimi në të cilin mbetet objektivi ynë strategjik, qartazi i shprehur me vullnetin e popullit dhe e vulosur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Dhe si shtyllë e tretë, Republika e Shqipërisë me të cilën ruajmë natyrshëm raporte të veçanta kombëtare, kulturore, gjuhësore e politike. U jemi që të gjithëve thellësisht mirënjohës.

U jemi mirënjohës vendeve e popujve të qytetëruar evropian, si dhe gjithë botës demokratike për mbështetjen që na e kanë ofruar në synimet tona. Është në traditën tonë që miqësitë t'i krijojmë, por edhe t'i ruajmë, sepse siç thonë të gjithë këtu në Kosovës, shtëpia jonë është edhe e mikut, e Kosova sado që mund të jetë afër ose larg gjeografikisht, do ta ketë gjithmonë derën e hapur për të gjithë ju miq të nderuar, e në mendjen e zemrën e çdo kosovari do të kultivohet përgjithmonë respekti e mirënjohja e thellë për miqësinë e për mbështetjen tuaj në momentet tona më të rënda.

Të dashur qytetarë,

Si drejtuese e institucionit më të lartë, si presidente e Republikës së Kosovës, si presidentja juaj, shfrytëzoj rastin t'i ftoj të gjithë politikanët e këtij vendi që së bashku ta ndërtojmë kulturën politike të bashkëpunimit e të tolerancës, të mirëkuptimit me njëri-tjetrin dhe të përkushtimit për shtetndërtim që shkon përtej ngjyrave politike.

Bashkëpunimi me Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe me të gjithë përfaqësuesit e qytetarëve të zgjedhur në Kuvend, uroj të jetë i përhershëm dhe dinamik, në mënyrë që të sigurohemi se Kosova do të vazhdojë të jetë vendi i qytetarëve të saj, që dallimet mes nesh në pikëpamje politike, kulturore, religjioze të jenë shtysë për kohezion nacional, që diversiteti i mendimeve të jetë thelbi i sjelljes për vlerat përbashkëta, që qëndrimet e ndryshme dhe në këtë Kuvend ta nxisin kultivimin e mëtejme të frymës së demokracisë.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Unë udhëhiqem nga vullneti juaj, sepse jam e bindur që vullneti juaj të dashur qytetarë, është udhërrëfyesi më korrekt e më i sinqertë, në mënyrë që të mund t'i shërbej vendit tim.

Ne kemi dëshmuar tradicionalisht kulturë të bashkëpunimit dhe të fqinjësisë së mirë. Këto janë ndër vlerat tona më fisnike të cilat do të vazhdojmë t'i kultivojmë edhe më tutje.

Por, në të njëjtën kohë, ne do ta thellojmë përpjekjen për shtetndërtim e domokratizim, për vendosje të drejtësisë e gjetje të drejtësisë e gjetje të drejtësisë për të gjithë, e sidomos për gjetje të drejtësisë për të gjitha viktimat e luftës, që për shumë nga ne është edhe e tashmja me të cilën jetojmë çdo ditë.

Gjersa do të punojmë pa u ndalur që drejtësia të jetë e vetmja përgjigje ndaj çdo padrejtësi, drejtësia e plotë për vendin tonë nuk do të arrihet, përderisa Seria të vendosë para drejtësisë kriminelët serbë që kanë kryer krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid kundër popullit të Kosovës, dhe kjo është e vërteta që nuk mund ta mohojë askush. Ka ndodhur para syve të tërë botës.

Dialogu është vërtet rruga që kemi përpara, por ai duhet të jetë i drejtë e i barabartë, e po paqja do të arrihet, vetëm kur të shohim pendesë nga Serbia, kur të kërkohet falje nga ajo dhe kur të vihet drejtësi për ata që kanë pësuar nga krimet e tyre.

Më të dashurit, qytetarë të vendit tim,

Këto nuk janë kohë të lehte për Kosovës, e as për mbarë njerëzimin. Sfidat janë të shumta, veçanërisht ajo me pandeminë, e cila kërkon që ne të bëhemi sërish bashkë që të mund ta luftojmë atë.

Prandaj, le t'i qëndrojmë pranë njëri-tjetrit dhe t'i japim përkrahje Qeverisë së vendit në menaxhimin e saj. Në këtë sfidë, fitorja e sukcesi nuk janë vetëm të njërës palë, fitorja do të jetë e përbashkët dhe vetëm të bashkuar do të mund ta bëjmë të mundur.

Për më shumë se një vit, njerëzimi po përballët me këtë të keqe. Kemi humbur shumë jetë njerëzish, e të tjera edhe mund të humbim. Shumë vende pune janë shuar, e përplot mundësi zhvillimi po ashtu, por përgjatë këtij viti ndodhën edhe mrekulli, gëzime, e vazhdoi të ngadhënjë e mira mbi të keqën, sepse vazhdoi të lindte jeta.

Sfidat e pandemisë shkaktuan inovacion në mënyrën se si bëjmë biznes, si tregtojmë, si ndërveprojmë, e thirrje për distancim fizik i shtuan përpjekjet tona të përbashkëta për solidarizim.

Në mënyrë që mirat të vazhdojnë të mbajnë ritmin, do t'ia dalim vetëm kur të qëndrojmë të bashkuar. Kur veprojmë me maturi, e me vendosmëri.

Sot, qëndroj përpara jush në këtë sallë, e përballë qytetarëve të vendit tim, duke qenë e vetëdijshme për pritshmëritë që i keni. Jam e vetëdijshme që për gratë e Kosovë, të cilat në këto zgjedhje aq shumë e përkrahën ndryshimin, u rilind edhe njëherë besimi se vajzat e Kosovës, nesër mund të jenë në vendin e gjithsecilit prej nesh.

Jam e vetëdijshme që ato presin nga ne që të merremi me të gjitha sfidat që sot përballët gruaja dhe vajza kosovare. Jam e vetëdijshme që personat me nevoja të veçanta presin që bisedat që i kemi bërë tash e sa kohë, të fillojnë të gjejnë zbatim. E unë ju premtoj se ashtu siç kemi bashkëbiseduar, po kështu bashkë kemi për të punuar për t'ju garantuar jetë me dinjitet, qasje e përfaqësim, sepse ne nuk ia kemi dalë dot si shtet, deri sa t'ia dalim të kujdesemi më së mirë për ata që kanë nevojë më së shumti për ne. Kështu e mati dhe e vlerësoj unë suksesin e çdo përpjekjeje tonë për progres në shtetndërtim.

Jam e vetëdijshme se printerët presin zhvillim e vende punë për bijtë e bijat e tyre të cilët do duhej të vazhdonin jetën e veprën në Kosovë. E unë ju premtoj që së bashku me juve, së bashku me deputetët e këtij Kuvendi, e me Qeverinë e Republikës sonë, do të punojmë ditë e natë që perspektiva të jetë sinonim për Republikës tonë të re. Por, jam edhe pak e vetëdijshme që ka ende shumë zëra që nuk kanë depërtuar e nuk i kemi dëgjuar, e juve ju premtoj që do të jem sy për të identifikuar vendndodhjen tuaj, e vesh për t'i dëgjuar nevojat tuaja.

Misioni ynë, të dashur deputetë, është shumë më shumë se sa angazhim politik ngaqë çdo mision i nisur me bekimin e qytetarëve e që derivon nga vullneti qytetar është mbi të gjitha mision fisnik, është mision i shenjtë. Andaj, nga ne pritët të dimë të dallojmë se si ta ndajmë të mirën nga keqja, të drejtën nga e padrejta, të bëjmë diferencën mes të tashmes dhe të kaluarës, të dimë se kur është koha e duhur të ndërmarrim veprime madhore të përbashkëta duke u siguruar që çdo vendimin ynë të na sjellë një hap më afër për Kosovën për të cilën flasim kaq shumë, një hap më afër Kosovës, ashtu siç e duam e ëndërrojmë ne sot, e e kanë ëndërruar shumë e shumë breza para nesh.

Të luftosh padrejtësitë e të sfidosh veprimet e gabuara, të shtysh përpara kauza që e përmirësojnë jetën e njerëzve që na rrethojnë, të qëndrosh fort prapa bindjeve tuaja kur e di që është e drejtë dhe duhet bërë, nuk është thjesht çështje një vote apo deklarimi publik, është përbushja më e madhe, është arritja më kulminante në realizimin me sukses të misionit tonë në këtë rrugëtim të përbashkët politik.

Veprime të tilla, veprime guximtare, veprime që i japin krahë shpresngjallës historisë sonë, janë dëshmia më e pastër e madhështisë të secilës e secilit nga ju.

Të dashur qytetarë të vendit tim,

Sot, zotohem para jush se do të punoj çdo ditë që ta forcojë më tej shtetin tonë, Republikën e Kosovës, sundimin e ligjit, të garantoj mbrojtjen e lirive themelore njerëzore dhe të jetës së dinjitetshme për të gjithë.

Sot, zotohem se do ta mbroj çdo pëllëmbë, çdo pëllëmbë të Republikës sonë dhe do të angazhohem pa kursim për të garantuar pacenueshmërinë e integritetit territorial, institucional e të sovranitetit të vendit.

Kosovën duhet ta bëjmë gjithnjë e më të fortë, sepse është mëmëdheu ynë, gjaku e munda i brezave të tërë dhe trashëgimie që ne ua lëmë pas brezave pas nesh.

Si presidente e të gjithë qytetarëve pa dallim, do të sigurohem që interesi ynë nacional të jetë mbi të gjitha. Që Kushtetuta jonë të jetë udhërrëfyes i ynë i përhershëm, që aleancat me miqtë tanë të ruhen e të thellohen, që kapitalit i jashtëzakonshëm njerëzor të fuqizohet e të angazhohet. Që e drejta të sundojë. Që natyra dhe jeta mbi të, të mbrohet. Që inovacioni të lulëzojë, që barazia të kultivohet, e puna e munda të shpërblehet.

Unë do të jem presidentja e juaj, presidentja e të gjithëve, e prirë nga gjithëpërfshirja në vendimmarrje e unifikuese në sfida e në të arritura.

Në këtë ditë të madhe kur vëllezërit e motrat tanë të krishterë festojnë pashkët, të rikujtojmë shpirtin e kësaj feste, ku dashuria ngadhënjën mbi urrejtjen, e mira mbi të keqën, e shpresa mbi zhgënjimin.

Ne duhet të flasim më shumë me njëri-tjetrit. Duhet ta demonstrojmë shpirtin përbashkues dhe zotohem sot para jush se unë do t'i prijë kësaj nisme.

Ne nuk jemi shumë për t'u ndarë në ne dhe ata, ne të gjithë jemi një, qytetarë të Republikës sonë të dashur të cilës i dedikohemi përjetësisht. Ajo qëndron fuqishëm mbi lirinë, pavarësinë dhe demokracinë të cilën po e fuqizojmë çdo ditë e më tepër.

Dera ime si presidente do të jetë e hapur për të gjithë. Nuk do të ketë parti nga pozita e opozita. Të gjithë bashkë jemi në shërbim të Kosovës, ndaj mbi këtë parim, unë jam vetëm njëra nga ju që po e vazhdoj detyrën e presidentes së vendit, të cilën e mora në rrethana jo të zakonshme, për të vazhduar në rrethana shpresoj më të zakonshme, në rrethana më shpresëdhënëse.

Prandaj, edhe njëherë dua t'ju falënderoj nga thellësia e zemrës gjithsecilin nga ju deputetë të nderuar për besimin e dhënë. Falënderoj secilin nga deputetët e koalicionit tonë të përbashkët me të cilin ndërtuam rrugëtimin tonë, rrugëtim ky i bazuar mbi kauzën dhe mirëqenien e qytetarëve tanë, mbi kauzën e drejtësisë për të gjithë ata.

Dua ta falënderoj kryeministrin e vendit, të gjithë ministrat, e gjithë Qeverinë, për bashkëpunimin, me shpresën që ky bashkëpunim do të thellohet edhe më tej. Dua t'ju falënderoj kolegët nga Lidhja Demokratike e Kosovës në krye me kryetarin Abdixhiku, me të cilët kam bashkudhëtuar rreth 21 vite, për kontributin e tyre në ndërtimin e institucioneve të vendit.

Dua t'ju falënderoj edhe deputetët e tjerë, deputeten Reshitaj, deputeten Grainca, deputetin Pacolli, të gjithë deputetët që përfaqësojnë komunitetin turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, që të gjithë bashkë sot dëshmuam se Kosova është atdheu ynë i përbashkët.

Ndërkaq, për deputetët që sot nuk janë në këtë sallë, zotohem para të gjithëve se do të jemi bashkë në çdo sfidë e në çdo fitore për atdheun tonë, Republikës e Kosovës.

Të dashur qytetarë,

Kur zgjidhet rruga e drejtë asnjëherë nuk është e lehtë e pengesat janë të mëdha, por kur përballeni me to, kujtojeni gjithnjë atë që heroi ynë kombëtar, Jusuf Gërvalla, e shkroi si mësim që e kishte marrë nga nëna e tij, nëna Ajshe: “Rruga e nderit është më zorshmja, por është e vetmja rrugë e drejtë për njeriun. E kush është munduar për nder, nder ka gjetur”.

Në këtë rrugëtim, të dashur kolegë, të dashur përfaqësues të popullit, shpresoj t'ju kem të gjithëve bashkudhëtarë. Na priftë e mbara! Zoti i bekoftë qytetarët e Kosovës! Zoti i bekoftë miqtë tanë! Zoti e bekoftë Republikën tonë! Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: E falënderoj Presidenten e Republikës së Kosovës për fjalën e saj të rastit. Duke e uruar zonjën Vjosa Osmani-Sadriu për zgjedhjen e saj Presidentë të Republikës së Kosovës, e po ashtu duke i falënderuar edhe qytetarët e Kosovës me rastin e zgjedhjes së saj, unë i mbyll punimet e seancës së sotme. Mirupafshim në seancat e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*